

URDHËR
Nr. 30, datë 18.1.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 682, DATË 21.12.2020, “PËR NDALIMIN
E LËVIZJES PËRMES RRUGËVE AJRORE ME BRITANINË E MADHE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, datë 21.12.2020, nr. 5612,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 682, datë 21.12.2020, “Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Britaninë e Madhe”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri në datën 18.1.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në datën 1.2.2021”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**